

Autoportret në silic

Portreti im nuk ka ndryshuar edhe aq,
me kokën pak të anuar sikur kërkon ndjesë.
Ndjesë për se? Ndjesë për çfarë
ndjesë se ndodhesha në vendin e gabuar, në kohën e duhur
apo në vendin e duhur, në kohën e gabuar
apo të dyja bashkë? Ndjesë se isha prani atëherë
kur më ishte kërkuar të isha e padukshme?
Mos e kërcit lugën kur ha, mos ëndërro me zë,
atje ku digjesh – mos bëj tym, atje ku lahesh – mos bëj shkumë,
atje ku shkërmoqesh – pendët merri me vete,
atje ku shpirti rrëzohet me lastik të këputur nëpër këmbë, ik e mos i dil
për zot,
dhe, besomë, jeta është më e lehtë
nëse je i padukshëm.
Dhe unë ndoqa atë rrugë që mu tha.
Qelq. Fillimisht isha xhami plot sharje i dritareve të shkollës fillore,
që lexohej veç në ditë pluhuri.
Më pas një monokël – ajo ç'ka besonte njëri sy, tjetri e vinte në dyshim.
Dhe vonë fillova të shkruaj... Isha xhami i trashë
i një teleskopi,
që yjet t'i jep në pëllëmbë të dorës.
Syri i njeriut po ai – i lodhur,
dhe yjet po ato – miliona vite dritë larg
gjithsesi unë nuk jam një lajm i rremë, por, veç i parakohshëm,
mashtrimi im është vetëm distancë.

Autoportret w krzemie

Mój portret aż tak się nie zmienił.
Głowa nadal lekko spuszczone,
jakby prosiła o przebaczenie.
Przebaczenie? Dlaczego? Za co?
Że znalazłam się w złym miejscu we właściwym czasie,
albo we właściwym miejscu w złym czasie
albo za jedno i drugie? Za to, że byłam,
choć zmuszano mnie do niewidzialności?
Nie stukaj łyżką przy jedzeniu, nie snuj marzeń na głos,
ukrywaj dym, kiedy płoniesz, i pianę, kiedy się myjesz,
kiedy się łamiesz, kości zabieraj ze sobą,
kiedy pęka dusza i spada ci pod nogi, porzuć ją, nie bierz jej w obronę.
Uwierz, życie niewidzialnych jest łatwiejsze.
I szłam drogą, którą mi wytyczono.
Szkoło. Wpierw byłam szybą w szkolnym oknie pokrytą wyzwiskami
widocznymi jedynie w kurzu.
Później szkłem w monoklu – gdy jedno oko patrzyło ufnie,
drugie podawało to w wątpliwość.
Potem zaczęłam pisać... i stałam się grubym szkłem
teleskopu,
który gwiazdy przynosi na dłoni.
To samo zmęczone ludzkie oko
i te same gwiazdy – odległe o miliony lat świetlnych.
Jestem przedwczesną, ale nie fałszywą wiadomością,
moim oszustwem jest jedynie dystans.

Mbase ndonjëherë nuk do të jem më qenia e padukshme,
kufiri dredhacak midis dy botëve,
do të kem zë, ngjyrë, e lexueshme edhe në një ditë me shi
unë që e di mirë se një përkulje e ndrojtur koke para fotografit
është vetëm alibi.

Może pewnego dnia przestanę być niewidzialną,
krętą granicą dwóch światów,
będę miała głos, kolor i będę widoczna nawet w deszczowy dzień,
bo wiem, że spuszczenie głowy u fotografa
to tylko alibi.